

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Biričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

M. R. S.ć, me vendbanim në ..., R. e Serbisë,

Kundër:

M. G., nga f. ..., K. Prishtinë,

Palë përgjegjëse,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 mars 2015, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA34048), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 29 Janar 2020, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. S., kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numër, KPA34048.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, i datës 30 Mars 2015, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër, KPA 34048.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

- Me datë 27 mars 2007, M. R. S., (tutje, pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tutje, AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e pronës bujqësore, ngastrës kadastrale, nr. ..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.09.85ha., ha, me kulturë tokë e kultivuar-arë e klasit të 4, e cila gjendet në vendin e quajtur "Bare ", në fshatin ..., Komuna e ..., (tutje: prona e kërkuar).
- Pala ankuese thekson se pronën e kërkuar e ka trashëguar pas vdekjes së babait të tij të ndjerë, ndërsa të njëjtën e ka humbur me datë 17.06.1999, si pasojë e konfliktit të viteve 1998/99, kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe kthimin e posedimit të saj, e cila tani është e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme.
- Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP ka paraqitur ndër të tjera dokumentet si në vijim:
 - Fletën Poseduese nr. ..., të datës 06.09.1984, sipas së cilës pala ankuese paraqitet si bashkëpronarë i ngastrës së kërkuar ..., me 1/3 pjesë ideale.

- Kontratën mbi ndarjen nr. ..., dt.20.10.1987, vërtetuar në Gjykatë Komunale Prishtinë, sipas së cilës vërtetohet ndarja e pasurisë së pa luajtshme edhe e ngastrës së kërkuar në mes të nënës së tij, vëllait dhe palës ankuese.
 - Certifikatën nga libri amë i të vdekurve, nr., dt. 08.12.1976, që dëshmon vdekjen e babit të tij R., me dt. 19.08.1975.
 - Certifikatën e lindjes, nr. ..., dt. 18.09.1997, në emër të tij.
4. Me datë 22 maj 2008, nga AKP, është bërë notifikimi fizik i pronës së kërkuar, në të cilën ishte e ndërtuar një shtëpi e re nga M. G. (tutje: pala përgjegjëse PP). I njëjti ka pretenduar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar duke e ka nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë, deklaron se pronën e kërkuar (vetëm sipërfaqen prej 7 ari të saj), e ka blerë në vitin 2004, nga pala e tretë E. S.i, të njëjtën e ka bartë në emër të tij, për mes kontratës së shitblerjes të vërtetuar në gjykatë në të cilën e ka ndërtuar shtëpinë.
5. Në mbështetje të pretendimeve të tij PP, në AKP, ka paraqitur këto dokumente;
- Kontratën e shitblerjes nr., të vërtetuar në gjykatë me dt.25.02.2005, të lidhur në mes të tij dhe palës së tretë, e cila dëshmon blerjen e sipërfaqe prej 7 ari nga prona e kërkuar.
 - Kopjen e planit ,dt.06.07.2005, në emër të tij, për sipërfaqen prej 00.07.00ha.,
 - Certifikatën e të Drejtave pronësore (CDP), UI-71914021-00590, dt.07.04.2008, që e paraqet PP M. G. pronarë të ngastrës kad., në sipërfaqe prej 00.07.00ha.,
 - Fletën Poseduese, nr. ..., dt.18.08.2004, që e paraqet palën e tretë, pronarë të ngastrës kad., në sipërfaqe prej 00.07.00ha.,
 - Vendimin gjyqësor nr. C.643/2014, dt. 03.04.2014, sipas të cilit gjykata themelore Prishtinë, e ka refuzuar propozimin e palës ankuese për sigurimin e kërkesë padisë së tij për pronën e kërkuar, kundër PP dhe palës të treta.
6. E. S. (tutje, pala e tretë), paraqitet në AKP, i cili deklaron se pronën e kërkuar ngastrën kad . 203/1, në sipërf. prej 00.09.85ha., e ka blerë nga R. S., dhe R. S., nëna e palës ankuese në vitin 2001, e cila më vonë ia jep autorizimin për regjistrimin e kësaj prone në emër të tij.
7. Pala e tretë konfirmon, se në vitin 2004, PP M. G. ia ka shitur sipërfaqen prej 00.07.00ha., të ngastrës kadastrale, nr. ..., ndërsa pjesën tjetër prej 00.02.85ha., ja ka bashkëngjitur ngastrës tjetër të tij.
8. Në mbështetje të deklaratës së tij, në AKP, ka ofruar këto dokumente;
- Certifikatën e të Drejtave Pronësore. (CDP), nr. ..., të dt.07.05.2013, që e paraqet palën e tretë si pronarë të ngastrës kadastrale nr., (nuk ka të bëjë me ngastrën e kërkuar).
 - Autorizimin, nr. ..., të dt.10.06.2003, të vërtetuar në gjykatën Komunale në Panqevë të dhënë nga pala ankuese ,nëna e tij dhe vëllai i tij si bashkëpronarë, sipas së cilit këta

e autorizojnë djalin e palës së tretë A. E. S., të nënshkruaj kontratën për shitblerje për ngastrën kadastrale lëndore nr. ..., në emër të tyre.

- Fletën Poseduese nr...., dhe Kopjen e planit, të dt. 29.05.2003, që e paraqesin palën ankuese, nënën e tij dhe vëllain e tij , bashkëpronarë të pronës së kërkuar.
9. Pala ankuese M. S., gjatë kontaktit me sekretarin e AKP-së, kishte konfirmuar se nëna e tij ia kishte shitur pronën e kërkuar me pëlqimin edhe të vëllait të tij, palës së tretë pas vitit 2000, megjithatë ai pretendon se ajo nuk ka pasur të drejtë ta shes këtë pronë. I njëjti kishte konfirmuar se ka ushtruar padi ndaj palës së tretë dhe palës përgjegjëse për vërtetim pronësie dhe kthimin e pronës.
 10. Sekretaria gjatë verifikimit dhe *ex officio*, kishte gjetur CDP, që e paraqet PP M. G. si pronarë të pronës së kërkuar ,ngastrës kadastrale, nr...., në sipërfaqe prej 00.07.00ha,.
 11. Me 30 mars 2015, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), me Vendimin e tij KPCC/D/A/267/2015, e ka hedhë poshtë kërkesën e palës ankuese. Në arsyetimin e vendimit grupor të ankimuar, (paragrafët 18-20), që aplikohet në mënyrë specifike për kërkesën, ndër të tjera theksohet se; komisioni bazuar në lloje të ndryshme të dokumenteve të paraqitura nga palët dhe të siguruara *ex officio* ,nga sekretaria dhe deklaratimet e më vonshme të paraqitësit të kërkesës ka gjetur se paraqitësi i kërkesë ka dështuar të dëshmoj se pamundësia aktuale për të ushtruar të drejtën pronësore i përfshin rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konfliktit i viteve 1998/99, andaj rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të KKPK dhe duhet të hedhet poshtë . Megjithatë komisioni vëren se vendimi i tij me hedhjen poshtë të kërkesës nuk e cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës(tani palës ankuese), për të kërkuar ndihmë juridike, që është në dispozicion në gjykatën kompetente.
 12. Me datë 26 Qershor 2015, Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar të autorizuarit të palës ankuese K. B. (i autorizuar sipas autorizimit të dt. 15.11.2011,për ngastra tjera, të dhënë nga pala ankuese me nr. pers. i l.nj. ..., dhe nr. i l.nj., br....) .
 13. Pala ankuese M. S., ka paraqitur ankesë në AKP, kundër këtij vendimi, me datë 23 dhjetor 2015, (e protokolluar me vulë të pranimit në AKP, në Prishtinë me datë të njëjtë 23. 12. 2015).
 14. Me datë 15 Qershor 2015, Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë M. G., i cili ndaj këtij vendimi nuk ka ushtruar ankesë.
 15. Me datë 26.07.2016, pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar kopjen e ankesës së paraqitur nga pala ankuese kundër vendimit të KKPK-së, në shkresat e lëndës nuk ka prova se ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës ankuese.

Pretendimet e palës ankuese;

16. Pala ankuese vendimin e KKKP-së, e konteston në tërësi për shkak të cenimit thelbësor të drejtës materiale ose procedurale dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, në par. II., të ankesës thekson se, është pronar i ngastrës së kërkuar të cilën e ka trashëguar nga babai i tij, të njëjtën nuk e nuk e ka shitur dhe askënd nuk e ka autorizuar për ta shitur, andaj është e tij, tutje thekson se tani kjo ngastrë është në emër të një personi të cilin nuk e njeh dhe asnjëherë nuk e ka parë.

Arsyetimi ligjor;

Pranueshmëria e ankesës

17. Ankesa e paraqitur nga pala ankuese është pranueshme. Gjithashtu kolegji e llogarit ankesën si të afatshme të paraqitur brenda 30 ditëve siç është përcaktuar me nenin 12.1, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, me që në shkresa të lëndës nuk ka fletë dorëzim, me të cilin do të konfirmohej pranimi i vendimit të ankimuar në datë të caktuar nga pala ankuese.
18. Në shkresat e lëndës faqe nr. 256, është fletë dorëzimi në bazë të cilit dëshmohet se vendimi në emër të M. S. i është dorëzuar K. B. me datë 26.06.2015. Megjithatë sipas autorizimit të cilin e bashkëngjisin në lëndë, nr. 9444/11, të dt.14.11.2011, të vërtetuar në Gjykatën komunale- dega në ..., nuk figuron se i autorizuari z. K. B., ishte i autorizuar ta përfaqësoj palën ankuese, për lëndën në shqyrtim KPA34048, përkatësisht për ta shitur, pronën lëndore-ngastrën kadastrale numër ...
19. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve në shkresat e lëndës, vendimit të apeluar dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
20. Nga shkresat e lëndës rrjedh se në këtë çështje pronësore, pala përgjegjëse deklaroi dhe ofron dëshmi se e ka blerë pronën e kërkuar në mënyrë të rregullt në vitin 2005, nga pala e tretë E. S., (sipërfaqen prej 0.07.00ha.). Në bazë të kontratës së shitblerjes dhe në kadastrë kjo pronë, evidentohet në emër të tij në të cilën ka ndërtuar shtëpinë,(provë i paraqet dokumentet e cekura si në par. 5, të këtij aktgjykimi).
21. Pala e tretë E. S., në AKP thekson se pronën e kërkuar, ngastrën kad. 203/1, në sipërfaq. të tërësisht prej 00.09.85ha., e ka blerë nga R. S., dhe R. S., (nëna e palës ankuese), në vitin 2001, e cila më vonë me djemtë e saj e autorizon djalin e tij për shitjen dhe regjistrimin e kësaj prone në emër të blerësve, (dëshmi i ofron dokumentet si në parag.6-8, të këtij aktgjykimi).
22. Në anën tjetër pala ankuese e mohon se e ka shitur pjesën e tij të pronësisë prej 1/3, të kësaj ngastrë, apo se ka dhënë autorizim për shitjen e saj, megjithatë i njëjti sekretarisë së AKP-së, i kishte konfirmuar se, ka njohuri që nëna e tij ia ka shitur këtë pronë palës së tretë, pas konfliktit të viteve 1998/99, po ashtu thekson se ajo nuk ka pasur të drejtë ta shes. I njëjti po

ashtu kishte konfirmuar se ka paraqitur padi në gjykatë të rregullt për vërtetimin e pronësisë ndaj palës së tretë dhe palës përgjegjëse, megjithatë nuk ka ofruar një vendim gjyqësor të plotfuqishëm. Në anën tjetër PP kishte paraqitur në vendim gjyqësor me të cilin ishte refuzuar kërkesa e palës ankuese për masë të përkohshme për pronën lëndore. Ky vendim ishte verifikuar pozitivisht nga sekretaria e AKP-së.

23. Në këtë lëndë sipas shkresave të saj dëshmohet po ashtu se, pala ankuese nuk kishte pengesa dhe i kishte në pronësi edhe pas vitit 1999, disa prona tjera në afërsi të pronës së kërkuar, të cilat cekeshin në vendimin për ndarje. Nga kjo dëshmohet se ai e kishte mundësinë e administrimit dhe ushtrimit të drejtës pronësore pas konfliktit ,për të cilat ngastra sipas autorizimit të vërtetuar nr. ...,dt.14.11.2011, në Gjykatën në Graçanicë, e kishte autorizuar z. K. B. për ti shitur.
24. Nga gjendja si më lartë gjykata supreme do të vërtetoj nëse KKPK-ja ka pasur kompetencë për të vendosur në mënyrë meritore nën këto rrethana kur pala ankuese e thekson se prona e kërkuar ishte e tyre ndërsa ishte shitur në mënyrë të pa ligjshme nga nëna e tij, e cila sipas tij nuk ka pasë të drejtë ta bëjë një gjë të tillë, andaj i konteston dokumentet e transaksionit të shitblerjes, të lidhura në vitin 2004/2005, lidhur me pronën e kërkuar.
25. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që lidhen me konfliktin, që përfshijnë rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë. Prandaj paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër për ri posedimin e pronës, nëse e vërteton të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, dhe se ai nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore, për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
26. Nëse komisioni verifikon se posedimi është humbur para ose pas datave të cekura si në nenin 3.1, si më lartë, apo që humbja e posedimit nuk ndërlidhet me konfliktin do ta hedhë poshtë kërkesën mbi bazën ligjore nga neni 11.4 (b) të Ligjit nr.03/L-079.
27. Nuk kontestohet ndërmjet palëve se pala ankuese, nëna e tij dhe vëllau kanë qen bashkëpronarë të pronës së kërkuar me nga 1/3, pjesë ideale, dhe prona në kadastër evidentohet në emër të tyre para dhe pas vitit 2000. Megjithatë sipas autorizimit të vërtetuar në gjykatë Komunale Paçevë, nr. 5122/03 të dt. 10.06.2003, pala ankuese nëna e tij dhe vëllai e kanë autorizuar djalin e palës së tretë S. E. Agron, për ta shitur dhe bartur në blerës, pronën e kërkuar. Me këto fakte dëshmohet se transaksioni i shitblerjes ka ndodhur pas viti 2000, që jep të kuptohet se nuk ka të bëjë me humbje posedimit si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99, por e shitblerjes së më vonshme. Dokumentet e shitblerjes nga sekretaria janë verifikuar pozitivisht dhe juridikisht të vlefshme.

28. Gjykata Supreme nga arsyet e lartë cekura konstaton se, Dokumentet e shitblerjes përmes së cilës është bërë transaksioni i pronës së kërkuar janë vërtetuar në gjykatë kompetente. Megjithatë nëse autorizimi është ligjrisht i vlefshëm apo jo të cilin e konteston pala ankuese edhe pse deklaron se është në dijeni se nëna dhe vëllai i tij e kanë shitur pronën e kërkuar pas vitit 2000, nuk është relevante dhe nuk mund të kundërshtohet në këtë procedurë në AKP, andaj nuk mund të shqyrtohet nga KKPK-ja, ose gjykata supreme, sepse nuk ndërlidhet me konfliktin e vitit 1998/99.
29. Sipas kohës së transaksionit dhe bartjes së pronës së kërkuar, tregohet se kontesti në fjalë i referohet bartjes së drejtës pronësore në mes të palëve i realizuar pas konfliktit. Andaj kjo çështje nuk mundet për tu ndërlidhur drejtpërsëdrejti me, ose nuk rezulton nga konflikti i armatosur, i ndodhur në Kosovë në vitet, 1998/99. Nëse transaksioni i shitjes së pronës së kërkuar është i ligjshëm apo jo, kjo çështje duhet të vërtetohet në procedurë gjyqësore në gjykata me kompetencë të rregullt e jo nga KKPK-ja..
30. Nga të lartë cekurat gjykata supreme arrin në përfundim se vendimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje ligjore apo me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike ashtu si theksohet në ankesë, andaj vlerëson se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë dhe ligjor me hedhjen poshtë të kërkesës, në përputhje me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, sepse e njëjta nuk bie brenda kufijve të juridiksionit dhe kompetencave të KKPK-së, andaj vendimi vërtetohet.
31. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe sipas nenit 13.3.(c), të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, dhe nenin 166 paragrafin 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

32. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-072-2016, me datë 29 Janar 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani

